

VENDIM
Nr. 702, datë 30.10.2019

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 564, DATË 29.9.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DHURIMIN UNESCO-S TË IKONËS ‘NGJALLJA E
LLAZARIT’, NË KUADËR TË 60-VJETORIT TË ANËTARËSIMIT TË
SHQIPËRISË NË KËTË ORGANIZATË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 564, datë 29.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për dhurimin UNESCO-s të ikonës ‘Ngjallja e Llazarit’, në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë”.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama